



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 92/2012
Prishtinë, më 22.01.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani, dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi, ZPRK; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja, INDEP; Visar Rushiti, GAP dhe Sylejman Blakaj, Kosova Sot, gazetar.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 15 dhe 17.1.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-187 për treguesit gjeografik;
6. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike;
7. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 15 dhe 17.1.2013

Procesverbalit nga mbledhja e datës 15 dhe 17.1.2013, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme

Kryetari – Tha se sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë, duhet ta shqyrtojmë në parim këtë projektligj, duke kërkuar nga deputetët që të paraqesin vërejtjet e tyre në parim, pastaj të formohen grupet punuese për t'i shqyrtuar dhe nxjerr amendamentet.

Deputetet **Teuta Sahatqija, Myzejene Selmani dhe Sala Berisha – Shala**, e përkrahën në parim projektligjin për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

Pas debatit, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji, ka këtë përbërje: Teuta Sahatqija, raportuese, Sala Berisha – Shala dhe Myzejene Selmani.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut

Kryetari – Theksoi se po ashtu, sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë, duhet ta shqyrtojmë në parim këtë projektligj. Ai kërkoj nga deputetët që të formohet edhe grupi punues më pas e hapi debatin.

Lutfi Zharku – Paraqiti vërejtje në parim, lidhur me “provimin profesional” që është paraparë si një lloj rivlerësim i inspektorëve dhe kjo paraqet konflikt më parimet e Ligjit për Shërbimin Civil. Ai gjithashtu paraqiti vërejtje edhe në lidhje me “raportimin e kryeinspektorit të ministrisë para ministrit” dhe “çështjet e informimit”, diçka që rregullohet me akte të brendshme dhe në nivel administrativ.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji, ka këtë përbërje: Myzejene Selmani, raportuese, Lutfi Zharku dhe Visar Ymeri.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-187 për treguesit gjeografik

Kryetari –Theksoi se po ashtu, sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë, duhet ta shqyrtojmë në parim këtë projektligj. Ai kërkoi nga deputetët të paraqesin vërejtjet e tyre në parim apo të rezervohen që t'i paraqesin në grupet punuese.

Pas debatit, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-187 për treguesit gjeografik.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-187 për treguesit gjeografik.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji ka këtë përbërje: Zenun Pajaziti, raportues, Hashim Deshishku dhe Biserka Kostiq.

6. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike

Kryetari – Theksoi pasi që të gjitha Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Raportin me amendamente të Projektligjit Nr. 04/L-159, për Zonat ekonomike dhe nuk kanë pas ndonjë vërejtje propozoj që të procedohet tutje.

Hashim Deshishku - Tha duhet edhe një herë ta rishikojmë *Amendamentin* 27, pasi që duhet të ceket limiti derisa mund të ndëshkohen personat juridik dhe personi përgjegjës i personit juridik, e jo te mbetet sikurse është tani.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike.

7. Të ndryshme

Çështje vijuese

Lutfi Zharku – Kërkoi si kryesues i grupit punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale që të shtyhet mbledhja e grupit punues, që është paraparë të mbahet nesër, më 23.01.2012, për arsyeje të shqyrtimit të materialit dhe deri sa të hartohet transkripti nga dëgjimi publik, që është mbajtur dje, më 21.01.2013

Kryetari - kërkoi nga stafi i komisionit që t'i informojnë më kohë kur do të mbahet mbledhja e grupit të punës, po ashtu të informojë të gjithë deputetet që janë të interesuar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit të punës për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit